



## VENDIMI MBI PRANUESHMËRI

Data e miratimit: 19 qershor 2019

Nr. i lëndës: 2016-14

**Milan Adančić**

kundër

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 19 qershor 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 15 janar 2019,

### I. PROCEDURA

1. Ankesa në këtë rast është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Me shkresën e datës 1 korrik 2016, Paneli ka informuar Misionin se ky rast është regjistruar.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli i ka kërkuar këtij dhe ankuesve të tjerë që të jalin informata shtesë lidhur me ankesat e tyre. Ankuesit fillimisht ishte përgjigjur përmes përfaqësuesit të tyre se nuk kishin informacione të mëtejshme lidhur me ato raste.
4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli i ka dërguar dy kërkesa shtesë përfaqësuesit të lartpërmendur për dhënien e informatave shtesë.

5. Më 20 tetor 2017, Paneli ka pranuar një përgjigje nga përfaqësuesi i ankuesve duke ofruar informata shtesë lidhur me dy raste, duke përfshirë edhe këtë të tanishmin.
6. Më 8 dhjetor 2017, Paneli ia ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve shefes së Misionit (ShM-së), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar atë që të parashtrojë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesat jo më vonë se datën 26 janar 2018.
7. Përmes letrës së datës 19 janar 2019, nga Misioni ishte kërkuar përsëri që të japë përgjigje për pyetjet deri më 16 shkurt 2019.
8. Vërejtjet e ShM-së u morën më 12 mars 2019, pas së cilës u janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë. Faktet dhe rr Ethanat përkatëse të këtij rasti janë në përgjithësi të ngjashme për nga Iloji dhe ngushtë të lidhura me lëndën përkatëse 2016-09 (Miroslav Trifunović).
9. Më 15 mars 2019, letra e ShM-së ishte parashtruar për informim tek ankuesi, të cilit iu ishte dhënë afat deri më 15 prill 2019 për të bërë ndonjë parashtresë tjetër si përgjigje ndaj asaj letre.
10. Ankuesi nuk e ka shfrytëzuar mundësinë që të ofronte parashtrime shtesë.

## I. PËRBËRJA E PANELIT

11. Pas dorëheqjes së një prej anëtarëve të tij të përhershëm, Paneli do të mblidhet në këtë çështje vetëm me dy anëtarë në përputhje me rregullat 11 dhe 14 të rregullores së punës së Panelit.

## II. FAKTET

12. Faktet e paraqitura nga ankuesi mund të përbolidhen si më poshtë.
13. Më 22 qershor 1998, Dušan Adančić, babai i ankuesit, Milan Adančić, ishte rrëmbyer rrugës për në punë pranë minierës së Belaçevcit, Komuna e Fushë Kosovës. Atë ditë, ai ishte zhdukur në rrethana të panjohura dhe nuk ishte parë më asnjëherë.
14. Ankuesja dhe familja e tij njoftuan Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë, KNKK-në në Serbi si dhe UNMIK-un dhe më pas EULEX-in Kosovë.

## III. ANKESA DHE QËNDRIMI

15. Ankuesi i referohet dy të drejtave të veçanta themelore të pasqyruara në dispozitat e mëposhtme: Nenit 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), nën drejtimin e saj procedural, i cili garanton të drejtën themelore të njeriut për jetën dhe ofron një detyrim për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimit; Nenit 3 të Konventës, i cili garanton të drejtën e një personi për të mos iu nënshtruar torturës ose trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose poshtërues.

16. Përveç këtyre dispozitave, Paneli vendosi *proprio motu* gjithashtu të komunikojë dhe të shqyrtojë rastin sipas neneve 8 dhe 13 të Konventës. Të njëjtat të drejta themelore të njeriut garantohen nga një numër i traktave të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Këto të drejta janë pjesë e një grupei thelbësor të të drejtave themelore të njeriut të cilat janë të garantuara për të gjithë si një çështje e së drejtës ndërkombëtare zakonore.
17. Këto të drejta janë pjesë e të drejtave themelore të të drejtave themelore të njeriut, të cilat janë të garantuara për të gjithë si një çështje e së drejtës ndërkombëtare zakonore.
18. Duke konsideruar marrëdhënien e ngushtë të familjes ndërmjet viktimës së drejtpërdrejtë - Dušan Ađančić - dhe ankuesit - Milan Ađančić - Paneli është i bindur që ankuesi mund të konsiderohet si viktimë sekondare e shkeljeve të supozuara dhe se, si e tillë, viktimë e mundshme në përputhje me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit.

#### IV. PARASHTRESAT E PALËVE

##### Ankuesi

19. Siç përmblidhet më lart, ankuesi pretendon se gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë duhet të kishte hetuar zhdukjen e vëllait të tij dhe ka dështuar ta bëjë këtë në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe vëllait të tij.

##### Shefja e Misionit (“ShM”)

20. Në letrën e saj të datës 12 mars 2019, ShM-ja ka treguar se si pjesë e transferimit të dosjeve nga UNMIK-u në EULEX Kosovë, një numër i dokumenteve të policisë së UNMIK-ut që kanë të bëjnë me zhdukjen më 22 qershori 1998 të nëntë individëve meshkuj të punësuar në lagjen Bellaçevc/Miniera e Belaçevcit, përfshirë Dušan Ađančić-in ishte transferuar në EULEX Kosovë. Zhdukjet ishin regjistruar nga UNMIK-u nën tre numra të rasteve: një numër i rastit i dhënë nga Njësia e Personave të Zhdukur të Policisë së UNMIK-ut (MPU) duke iu referuar zhdukjes së nëntë individëve, një numër i rastit nga një degë tjetër e Policisë së UNMIK-ut, Njësisë Qendrore të Hetimeve Penale (NJQHP) duke iu referuar tetë individëve, dhe një numër i rastit nga stacioni i Policisë së UNMIK-ut të Leposaviçit duke iu referuar nëntë individëve. Sipas informatave nga dosja e NJPZH-së, dosja e plotë e lëndës ishte transferuar tek shefi i NJQHP-së për hetime të mëtejshme në shkurt të vitit 2000; ShM-ja vë në dukje se duket që dokumentet nga të dy dosjet nuk ishin bashkuar.
21. ShM-ja gjithashtu sugjeron që dokumentet nga dosjet e gjeneruara nga NJPZH dhe stacioni i Policisë së UNMIK-ut në Leposaviç i ishin dorëzuar stafit të EULEX-it Kosovë që punojnë në atë që tanë quhet Institut i Mjekësisë Ligjore IML (më parë Departamenti i Mjekësisë Ligjore). Dokumentet që gjenden në dosjen e gjeneruar nga NJQHP së bashku me disa, por jo të gjitha dokumentet nga dosja e NJPZH-së, i ishin dorëzuar Njësisë së EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Luftës (NJHKL).

22. Në një datë të pasaktësuar, dosja e NjQHP-së së UNMIK-ut iu ishte dorëzuar NJHKL-së së EULEX-it Kosovë si një hetim i mbyllur i kimeve të luftës dhe përbajtja e tij ishte shqyrtuar në fillim të mandatit të Misionit në vitin 2009 nga NJHKL-ja dhe nga prokurori i EULEX-it Kosovë PSRK. Një numër i PSRK-së ishte caktuar më pas në dosjen e lëndës.
23. Informatat që gjenden në dosjet e dorëzuara nga UNMIK-u sugjerojnë se zhdukja e z. Ađančić iu ishte raportua autoriteteteve serbe, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) dhe UNMIK-ut. Dosja përmban gjithashtu një deklaratë të datës 24 korrik 2001 të dhënë nga babai i Dušan Ađančić-it në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë.
24. Sipas ShM-së, lënda e NJPZH-së lidhur me këtë rast “duket se është transferuar vetëm tek stafi i EULEX-it në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Aktualisht nuk ka asnjë indikacion se NJHKL-ja e EULEX-it Kosovë ka marrë të njëjtën dosje”.
25. Më 28 janar 2008, përfaqësuesit e UNMIK-ut biseduan me ankuesin, Milan Ađančić-in.
26. ShM-ja vë në dukje se ishte e qartë se dosjet e marra nga UNMIK-u ishin jo të plota dhe, në shumë raste, nuk ishin organizuar siç duhet. ShM-ja gjithashtu thekson faktin se UNMIK-u nganjëherë kishte organizuar dhe emëruar dosjet në mënyrë jokonsekiente dhe kontradiktore dhe se i njëjti rast ndonjëherë ishte regjistruar në disa dosje e nuk ishin kombinuar në një dosje të vetme hetimore. Si rezultat, shqyrtimi i këtyre dosjeve nga Misioni doli të ishte një sfidë e madhe, e cila ishte penguar nga sfida të ndryshme duke përfshirë mungesën e një sistemi të menaxhimit të rasteve, largimin e lartë të stafit dhe rikonfigurimin e NJHKL-së në vitin 2014 që rezultoi me heqjen e kapaciteteve të inteligjencës dhe hulumtimit.
- 27.
28. Duket se përbajtja e dosjeve policore të “kimeve të luftës” dhe të dosjeve të personave të zhdukur nuk janë krahasuar apo bashkuar nga Misioni menjëherë pas dorëzimit nga UNMIK-u.
29. ShM-ja gjithashtu thekson se dosjet e UNMIK-ut nuk tregojnë apo sugjerojnë se UNMIK-u do të kishte ndërmarrë ndonjë hap hetimor në këtë rast.
30. ShM-ja gjithashtu thotë se duke pasur parasysh burimet e kufizuara në dispozicion të Misionit në atë kohë, NJHKL-ja e EULEX-it Kosovë u dha përparësi shqyrtimit të të ashtuquajturve ‘dosjeve të kimeve të luftës’ ndaj dosjeve të personave të zhdukur. Përpjekjet për t'i grumbulluar dhe vendosur të gjitha informatat që ishin në dispozicion të njësive të ndryshme të EULEX-it Kosovë në ZyLAB kishte filluar vetëm në vitin 2017 dhe nuk mund të përfundoheshin para se të transferoheshin tek institucionet e Kosovës në qershor 2018.
31. Në janar të vitit 2009, NJHKL e EULEX-it Kosovë e ka dërguar dosjen e UNMIK-ut në lidhje me ankesat në fjalë tek prokurori i EULEX-it në PSRK për shqyrtim dhe vlerësim. Emrat e dy individëve u përmendën si ‘të dyshuar’ në një dokument të analizës së lëndës të vitit 2007; i njëjti dokument tregoi se nuk kishte prova për të mbështetur

akuzat ndaj këtyre dy individëve. Dosja përbante gjithashtu një numër të kufizuar të dokumenteve, duke përfshirë edhe kallëzimet penale pranë "Zyrës Ndërkombëtare të Prokurorisë të Prokurorit Publik të Qarkut" të parashtruar nga tre të afërm të katër prej viktimave, duke përfshirë edhe z. Aðançic.

32. Më 20 korrik 2009, prokurori i EULEX-it në PSRK nxori një aktvendim për të hedhur poshtë raportin e NjQHP-së së policisë së UNMIK-ut. Prokurori e bazoi konkluzionin e tij mbi faktin se dosja nuk përbante "asnje element që mund të conte në identifikimin e një të dyshuarit të mundshëm dhe gjithashtu se nuk ishte e mundur që hetimet e mëtejshme nga policia të siguronin informata të miaftueshme". Aktvendimi rendit pesë 'palë të dëmtuara', duke përfshirë edhe z. Aðançic.
33. ShM-ja pohon se prokurori i EULEX-it Kosovë ka shqyrtuar vetëm një pjesë të dokumenteve të dorëzuara nga UNMIK-u pasi që ai nuk duket të ketë qenë në dijeni të dokumenteve shtesë të dorëzuara tek Instituti i Mjekësisë Ligjore.
34. Në të njëjtën ditë, prokurori i EULEX-it Kosovë i PSRK-së lëshoj një njoftim në lidhje me hedhjen poshtë të raportit penal tek të afërmit e katër prej pesë të të dëmtuarve të përmendorur në aktvendim, njëri prej të cilëve ishte z. Aðançic.
35. Lidhur me karakterizimin ligjor të rasteve, ShM-ja thotë si në vijim. Qëndrimi ishte marrë me sa duket në atë kohë se një rast të konsiderohej rast "krim lufte", krimi duhet të kishte ndodhur mes periudhës së shkurtit 1998 dhe 21 qershorit 1999, kur konflikti i armatosur mendohet se ka ndodhur në Kosovë. Sipas "Ligjit mbi PSRK" dhe "Ligjit mbi Juridikcionin", në periudhën 2008-2014, prokurorët e EULEX-it Kosovë kishin kompetencë ekskluzive për të ndjekur penalisht rastet e kimeve të luftës dhe kategorive të tjera të kimeve të rënda. ShM-ja tregon në këtë drejtim se:

"Nga një rishikim i të dhënave të EULEX-it Kosovë del se kurdoherë që prokurorët e EULEX-it Kosovë kanë hasur në një dosje të lëndëve që kanë të bëjnë me veprat e pretenduara penale (përfshirë vrasjet dhe rrëmbimet) që kanë ndodhur pas datës 21 qershor 1999, ata e konsideronin veten jo kompetent dhe i dërgonin ato lëndë tek Prokuroria përkatëse e Qarkut. EULEX-i Kosovë e kupton se sipas mendimit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, një numër i këtyre rasteve mund të ishin hetuar nga PSRK si "krim lufte" ose "krim kundër njerëzimit" me kusht që elementet e këtyre veprave penale të konsideroheshin se ekzistonin. Megjithatë Misioni duhet të konkludojë se në kohën përkatëse, autoritetet prokuroriale të EULEX-it Kosovë konsideronin se në dritën e burimeve të kufizuara në dispozicion dhe numrit të madh të lëndëve të kimeve të luftës, dërgimi i këtyre rasteve në Prokuroritë e Qarkut ishte rruga e duhur e veprimit".

ShM-ja gjithashtu vëren se EULEX-i Kosovë ka hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e zhdukjeve me forcë "nën një ombrellë më të gjerë të kimeve të luftës".

36. Në vitin 2011 dhe 2012, stafi i EULEX-it Kosovë në Departamentin e Mjekësisë Ligjore kreu gërmime në një vend ku besohej se trupat e nëntë të punësuarve të zhdukur të minierës mund të ishin varrosur. Gërmimi nuk ka çuar në ndonjë gjelje relevante.

37. Në korrik 2013, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara (PKDNj) lëshoi një vendim për ankesat e anëtarëve të familjes të disa individëve që u zhdukën më 22 qershor 1998, duke përfshirë edhe z. Aðançic. PKDNj-ja gjeti shkelje të të drejtave themelore të viktimate që i atribuohen UNMIK-ut dhe i rekomandoi, ndër të tjera, UNMIK-ut që të shtyjë EULEX-in Kosovë dhe autoritetet vendore që të ndërmerrnin të gjitha hapat e mundshëm për të hetuar këtë çështje. Vendimi i PKDNj-së iu dërgua Misionit më 15 nëntor 2013.
38. Më 26 nëntor 2013, kryeprokurori i EULEX-it i shkroi kryetarit të PSRK-së (i cili në atë kohë ishte prokuror i EULEX-it) për t'ia sjellë në vëmendje vendimin e PKDNj-së dhe rastet në fjalë dhe duke kërkuar që të ndërmerrin veprime të mundshme në lidhje me ato. Megjithatë ShM-ja thotë se EULEX-i Kosovë "nuk është në dijeni të masave që kryetari i PSRK-së mund të ketë vendosur t'i ndërmerrte në këto raste".
39. Më 11 qershor 2018, një prokuror i EULEX-it Kosovë i PSRK-së shkroi një letër për të njoftuar tre të afërmit e të zhdukurve që kishin paraqitur kallëzime penale në "Prokurorinë Ndërkombëtare të Prokurorit Publik të Qarkut" në vitin 2009; letra deklaroi se ky hap ishte duke u ndërmarrë, sepse shkresat e lëndës nuk përbëheshin prova se ata ishin njoftuar më herët lidhur me hedhjen poshtë të raportit penal. Për të siguruar dorëzimin e letrës palëve të dëmtuara në Serbi, më 12 qershor 2018, kryeprokurori i EULEX-it Kosovë i PSRK-së dërgoi një kërkessë për ndihmë të ndërsjellë juridike tek autoritetet serbe përmes Departamentit të Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.
40. ShM-ja tregon se nuk është në gjendje të konstatojë nëse ndonjë anëtar i familjes së të zhdukurve ka kontaktuar ndonjëherë me NJHKL-në e EULEX-it Kosovë apo prokurorët e EULEX-it. ShM-ja gjithashtu thekson se dosja e NJQHP-së së UNMIK-ut i është dorëzuar NJHKL-së së EULEX-it Kosovë ndërsa Misioni nuk e di pse dosja e NJPZH-së së UNMIK-ut është dorëzuar vetëm tek stafi i Institutit të Mjekësisë Ligjore të EULEX-it Kosovë. ShM-ja arriti në përfundimin:
- "Derisa mund të thuhet se EULEX-i Kosovë ishte njoftuar për zhdukjen e z. Aðançic pas transferimit të dosjeve nga UNMIK-u më 2008-2009, autoritetet e tij të policisë dhe prokurorisë u njoftuar vetëm në lidhje me informacionin që gjendet në dosjet e NjQHK/NjKL dhe nuk ishin në dijeni se ekzistonte informata shtesë në një dosje të veçantë të transferuar tek stafi i Institutit të Mjekësisë Ligjore të EULEX-it Kosovë".
41. Më 5 nëntor 2018, dosja e PSRK-së u transferua nga Misioni në Institucionet e Kosovës. Letra shoqëruese tregoi se rasti ishte 'hedhur poshtë' nga EULEX-i në korrik 2009, por gjithashtu ftoi autoritetet e Kosovës që të bëjnë vlerësimin e tyre lidhur me çështjen për të verifikuar "nëse ata ishin ende në posedim të ndonjë materiali tjetër që lidhej me rastin".
42. Misioni nuk është në dijeni rrëth ndonjë hetimi në vazhdim e sipër rrëth këtij rasti nga autoritetet e Kosovës.

43. Duke marrë parasysh juridiksionin e Panelit, ShM-ja nuk e konteston pranueshmërinë e këtij rasti.

## V. VLERËSIMI I PANELIT

*Mandati i Panelit (Rregulli 25, parografi 1 i rregullores së punës) dhe kompetenca ratione materiae*

44. Siç është cekur më lart, ShM-ja nuk e konteston pranueshmërinë e kësaj lënde.
45. Duke shqyrtuar kërkesat përkatëse të pranueshmërisë, Paneli është i bindur se rasti është në të vërtetë i pranueshëm.
46. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohet në Konceptin e Përgjegjshmërisë së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standarde minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike.
47. Para shqyrimit të ankesës mbi bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendosë nëse duhet të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29 të rregullores së punës.
48. Sipas rregullës 25, parografi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
49. Paneli tashmë ka vendosur që veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe për këtë arsy bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull, *K-T kundër EULEX-it*, 2013-05 në 2013-14, 21 prill 2015, para 43, *Krlić kundër EULEX-it*, 2012-21, 26 gusht 2014, parografi 23, *Y kundër EULEX-it*, 2011-28, 15 nëntor 2012, parografi 35). Ky është rasti i veprimeve pozitive ose i dështimeve të fajshme.
50. Të drejtat që i nënshtrohen kësaj ankese janë ndër të drejtat më të rëndësishme prej të gjitha të drejtave themelore. Ata prekin interesat thelbësore të viktimate të supozuara dhe duhet të garantohen në të gjitha rrethanat. Praktika e zhdukjes me forcë përbën një shkelje të egër të këtyre të drejtave. Kjo reflektohet *ndër të tjera* në faktin se tanj kjo konsiderohet dhe karakterizohet si një krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (Statuti i Romës, neni 7(1)(i)) dhe në Ligji mbi Dhomat e Specializuara dhe Prokurorisë Speciale (Ligji nr. 05/L-053) (Neni 13(1)(i)).
51. Paneli është i bindur që ngjarjet nën shqyrtim kanë ardhur *ratione materiae* brenda fushës së përgjegjësisë së Misionit, në veçanti, por jo vetëm, përmes mandatit të

prokurorëve të tij dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore. Paneli thekson në këtë drejtim se dosja e lëndës në fakt ishte subjekt i një shqyrtimi nga EULEX-i Kosovë.

52. Implikimet e ndryshimeve në mandatin e Misionit pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të Misionit në qershor 2018 dhe implikimet e tyre për qëllimin e këtij rasti do të adresohen, kur është e nevojshme, në vendimin e tij mbi bazueshmërinë. Palët janë të ftuara për të adresuar këtë çështje nëse dëshirojnë të bëjnë parashresa të mëtejshme në lidhje me meritat e kësaj çështje.

#### *Kompetenca ratione temporis*

53. Për më tepër Paneli gjithashtu thekson se ankuesi mori shumë hapa për të parë se çështja duhet të hetohet nga ata është i konsideronte kompetent për ta bërë këtë. Nuk duket se atij formalisht iu ishte bërë me dije nga cilido autoritet përkatës se ata nuk ishin kompetent ose nuk do ta shqyrtonin kërkesën e tij. Kompetenca e Panelit *ratione temporis* nuk kontestohet nga ShM-ja dhe Paneli është i bindur që kjo kërkesë është plotësuar dhe se ankuesi ka respektuar afatin e kërkuar 6 mujor brenda të cilit duhet të paraqitet një ankesë.
54. Paneli thekson që *ratione temporis* është kompetente të shqyrtojë veprimet e Misionit deri më 14 qershor 2018. Pas kësaj date, Misioni nuk kishte ndonjë përgjegjësi ekzekutive mbi këtë rast. Megjithatë aktivitetet e kryera pas kësaj date mund të janë relevante për të vlerësuar shkallën në të cilën Misioni ka përbushur detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Rrjedhimisht, Paneli fton që Misioni të ofroj referanca në parashtrimet e tij për çdo përpjekje të ndërmarrë nga Misioni për të siguruar që ky rast është duke u hetuar (nëse ka), përfshirë pas kësaj date ose çfarëdo hapi tjetër që merret nga Misioni për përbushjen e detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut.

#### *Kompetenca ratione personae*

55. ShM-ja nuk e konteston kompetencën *ratione personae* të Panelit dhe Paneli është vërtetë i bindur që është kompetent edhe në këtë drejtim.

### **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

**SHPALL TË PRANUESHME**, pa paragjykuar meritat e çështjes, ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

**KËRKON** palët që t'i adresojnë pyetjeve vijuese:

#### **I. PËR SHEFEN E MISIONIT:**

- A ishin shpërndarë dosjet që kishin të bënin me këtë rast në posedim të Institutit të Mjekësisë Ligjore ndonjëherë tek prokurorët e EULEX-it? Nëse jo, cila është arsyja?

- ii. Cilat hapa (nëse ka) janë marrë nga Misioni për të siguruar bashkërendimin ndërmjet organeve të ndryshme të tij për të centralizuar dhe ndarë informatat që kanë të bëjnë me hetimin në vazhdim e sipër të veprave të rënda penale, përfshirë rastet e "zhdukjeve me forcë"?
- iii. A është misioni kompetent për të monitoruar këtë rast pa autoritetet vendore që kanë filluar një hetim për të? Nëse jo, çfarë është Misioni i autorizuar të bëjë, sipas mendimit të tij, kur autoritetet vendore dështojnë të përbushin obligimet e tyre procedurale sipas nenit 2 ose 3 të Konventës?
- iv. Ju lutemi ofroni një kopje të letrës së datës 11 qershor 2018. A ka kryer Misioni ndonjë ushtrim të ngjashëm në secilin rast për të siguruar që të afërmit e individëve të zhdukur janë njoftuar lidhur me hedhjen poshtë të lëndës kur kjo kishte ndodhur gjatë mandatit të EULEX-it ose a është ky zhvillim i veçantë për këtë rast?
- v. Në parashtresat e veta, Misioni ka dhënë shenja se "është konsideruar jo e mundur që hetimet e mëtejshme nga policia do të siguronin informata të mjaftueshme" (shih, më lart, paragrafin 26). Cilat ishin faktorët apo konsideratat që çuan deri në atë përfundim? Nga kush është bërë kjo dhe kur?
- vi. Në parashtrimet e tij (të përbledhura në paragrafin 21 më lart), Misioni tregon se si rezultat i rikonfigurimit të NJHKL-së në vitin 2014, ishin hequr kapacitetet e inteligjencës dhe hulumtimit. Kush e mori atë vendim? Bazuar në çfarë faktorë dhe konsiderata?

## I. PËR ANKUESIN:

- i. Çfarë kontaktesh keni pasur me Misionin e EULEX-it gjatë periudhës 2008-2014 në lidhje me këtë rast? Në veçanti, cili ishte natyra dhe niveli i kontakteve tuaja me Institutin Mjeko-ligjor të EULEX-it?
- ii. A jeni informuar se në vitin 2009, EULEX-i Kosovë vendosi të mbyllë çështjen që ka të bëjë me zhdukjen e nëntë punëtorëve të minierës, duke përfshirë edhe të afërmin tuaj?
- iii. Ju lutemi përshkruani efektin - finansiar, personal dhe emocional – që zhdukja e të afërmit tuaj ka pasur mbi ju.

Për Panelin

Z. Guénaël METTRAUX  
Kryesues



Znj. Anna Bednarek  
Anëtare